



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:224949 C. nr. 4411/2024
Datë: 04.02.2025
Numri i dokumentit: 06802738

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – gjyqtari Atdhe Berisha, me praktikanten e kësaj gjykate E.M.a në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve: L.Sh. dhe K.S. të dyja nga Mamusha të cilat i përfaqëson A.H. avokat nga Prishtina kundër të paditurës Drejtoria e Arsimit Prizren për kompensim i kualifikimit, jashtë seancës, me datë 04 Shkurt 2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Pranë Gjykatës Themelore në Prizren, është iniciuar procedura kontestimore, sipas padisë së paditësve L.Sh. dhe K.S. të dyja nga Mamusha të cilat i përfaqëson A.H. avokat nga Prishtina kundër të paditurës Drejtoria e Arsimit Prizren

I autorizuari i paditësve me parashtresën e datës 08.01.2025, ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë në këtë çështje kontestimore sepse palët nuk kanë interes ta vazhdojnë më tutje këtë çështje.

Pasi që pala padiëse e tërheq padinë në këtë çështje kontestimore, gjykata në kuptim të nenit 261 të LPK-së, vendosi që të konstatohet se padia është tërhequr.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 4411/2024 datë 04 Shkurt 2025

Praktikante:
Erolina Morina

Gj y q t a r i
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.